



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MBROJTJES

SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA

Komanda e Forcës Ajrore

NJOFTIM PËR PJESËMARJE

Autoriteti Kontraktor, Komanda e Forcës Ajrore/Reparti Ushtarak nr.3001, Rinas, Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit të thjeshtuar për “Përcaktim kolaudatori për kolaudim të punimeve me objekt ”Ndërtim i perimetrit të sigurisë dhe faciliteteve përbërëse në venddislokimin e radarit në Mide”

Data e zhvillimit të prokurimit do të jetë 14.09.2021, ora 10:00, në adresën: Faqja e internetit te Forcës Ajrore.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna: (specifikimet teknike shërbimit/punës):

Nr	Emërtimi	Vendi
1	Përcaktim Kolaudatori per Kolaudim të punimeve në objektin: Ndërtim i perimetrit të sigurisë dhe faciliteteve përbërëse në venddislokimin e radarit në Mide”	Reparti Ushtarak 3001 (Rajoni Mide)

Në përgatitjen e ofertës, ofertuesit duhet të respektojnë Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manulait të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) Nr. 5585 Prot, datë 25.07.2017,” Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave” me qëllim respektimin nga operatorët ekonomikë të normave minimale (vlerave minimale të lejuara), të specifikuara në këtë vendim, Ligjin nr 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”

- Vendodhja: Reparti Ushtarak 3001, Rajoni Mide.

Shërbimi i kërkuar duhet të kryhet në mbështetje të ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 ”Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar), Udhezimit të KM Nr 3 datë 15.02.2001 për ”Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit” (i ndryshuar).

Afati i realizimit të shërbimit do të jetë 20 (njetzet) dite nga lidhja e kontrates.

Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor brenda 3 ditëve nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit. (nese dita e paraqitjes bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afat i mbaron në ditën e punës që vjen pas saj), dhe do të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor (në rastet kur kërkohet), dokumentet si më poshtë:

- Ofertën me çmime,
- IBAN-i për efekt të kryerjes së pagesës në rast se shpallet fitues.
- Liçense profesionale lëshuar nga organet përkatëse “Për Mbikqyrje e Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e cila të përmbajë kategorit e mëposhtme:

Punime të përgjithëshme ndërtimi:

NP-1 A (Punime gjurmimi në tokë)

NP-2 A (Ndërtime civile dhe industriale)

NP-3 A (Rikonstrukcion e mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash)

NP-4 A (Rrugë autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.)

NP-7 A (Ujesjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje)
NP-11 A (Ndërtim për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja TN e te mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike)

Punime speciale ndërtimi:

NS-2 A (Impiante hidro-termosanitare, kuzhina, lavanteri dhe mirëmbajtja e tyre)
NS-4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)
NS-8 A (Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.)
NS-10 A (Shtresa dhe mbistruktura speciale)
NS-12 A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit)
NS-13 A (Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni)
NS-14 A (Impiante të brëndshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV etj)

Gjithashtu në zbatim të udhëzimit nr.7 date 17.02.2021 të MM, operatorët ekonomike përpara fillimit të procedurës duhet të zotërojnë nivelin e kërkuar “konfidencial” të CSI dhe CSP, për personelin që perfaqson operatorin ekonomik dhe të gjithë individët e tjerë që do të kenë akses në informacionin e klasifikuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Shënim: Operatori ekonomik fitues për nënshkrimin e një kontrate/dorëzimit e fatures tatimore duhet të ketë:

- Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformen Qëndrore të Faturave.
- Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe kopje të velfshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e çertifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentet si më poshtë:

1. Ekstraktin e shoqërisë nga QKR ku të tregohet objekti i veprimtarisë (të jetë i tre muajve të fundit)
2. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që i ka paguar detyrimet fiskale (i tre muajve të fundit)

Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Kolonel Ylli PULAJ